



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 138, Datë 21.08.2020

“MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.08.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., si dhe relacionin nr.96/2Prot, datë 13.08.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997 prot, datë 22.07.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është **plotësuar pjesërisht**.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është **plotësuar pjesërisht**.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është **plotësuar pjesërisht**;
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është **plotësuar pjesërisht**.
- Shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 07.08.2017, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. ka: Financimin, ndërtimin e hidrocentraleve, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike. shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve, bazuar në ligjet e shtetit shqiptar.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2,
 - **gërma “c”** (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra kombëtare e biznesit, (QKB). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria ka përcjellë në ERE Ekstraktin historik të QKB-së, datë 14.01.2020, nga përmbajtja e të cilit rezulton se shoqëria është regjistruar në datën 07.08.2017. Do ti kërkohet shoqërisë të përcjellë Çertifikatën e regjistrimit pranë QKB-së dhe ekstraktin të përditësuar në data.
 - **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të paraqesë Vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. dhe përfaqësuesin ligjor të saj (neni 7, pika 4, gërma “b”).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal.
 - **Neni 9, pika 3, gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8,
 - **gërma “a”.** Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve.
 - **gërma “b”.** Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI